

VENDIM
Nr. 557, datë 18.6.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I RRUGËS “DON GJON BUZUKU”, RIJETËSIMI I SHESHIT TË XHAMISË “ILJAZ BEJ MIRAHORI”, RINDËRTIMI I KULLËS HISTORIKE TË SAHATIT, RIJETËSIMI I SHESHIT TË HYRJES DHE RIKONSTRUKSIONI I DISA RRUGICAVE TË PAZARIT HISTORIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës “Don Gjon Buzuku”, rijetësimi i sheshit të xhamisë “Iljaz bej Mirahori”, rindërtimi i kullës historike të sahatit, rijetësimi i sheshit të hyrjes dhe rikonstruksioni i disa rrugicave të Pazarit Historik.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall, me një vlerë të përgjithshme prej 30 144 830 (tridhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 30 144 830 (tridhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e tridhjetë) lekësh, të përballohet nga subjekti kërkues, Bashkia Korçë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë në datën 19.6.2015.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Korçë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Zgjerimi i Rugës "Don Gjon Buzuku", Rijetësimi i Sheshit të Xhamisë "Iljaz Bej Mirahori", Rindërtimi i Kullës Historike të Sahatit, Rijetësimi i Sheshit të Hyrjes dhe Rikonstruksioni i Disa Rugicave të Pazarit Historik"

Nr. Rendor	Vol.	Faq.	Nr. Pasurie	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i Pas.	Truall. (m ²)	çmimi për m ²	Vlera Total per Shpronësim
1	38	198	3/959	Shtet	Shesh	2665	8537	0
2	12	117	3/664	Katerina Kristaq Veriga + bpr	Truall	20.77	8537	177,313
3	11	56	3/492	Ana Shain Veriga + bpr	Truall	20.77	8537	177,313
4	17	67	3/575	Ismail Adem Zhilla	Truall	36.18	8537	308,869
5	17	223	3/585	Jani Dhoskë Simo	Truall	42.88	8537	366,067
6	21	5	3/615	Romeo Niko Titka	Truall	20.00	8537	170,740
7	12	100	3/654	Petrika Kozari, Stavri Kozari	Truall	74.55	8537	636,433
8	28	157	3/358	Nedibe Sejdarasi + bpr	Truall	20.00	8537	170,740
9	24	33	3/686	Gjinovefa Zado	Truall	19.00	8537	162,203
10	14	110	3/535	Jeta Aliqemal Feimi (Tuxhari)	Truall	46.66	8537	398,336
11	14	179	3/532/1	Sotirraq Petraq Tego	Truall	93.33	8537	796,758
12	38	199	3/960	Myftinia Korçë	Truall	105.00	8537	896,385
13	15	157	3/537	Bashkëpronar (Nrb/pronar 33)	Truall	355.00	8537	3,030,635
14	36	139	3/780	Ymer Ahmeti	Truall	42.50	8537	362,823
15	18	67	3/587	Kristaq Lubonja + bpr	Truall	28.80	8537	245,866
16	11	3	3/643	Romeo Xhuvi Zallëmi	Truall	50.40	8537	430,265
17	18	108	3/199	Koço Katundi + bpr	Truall	22.30	8537	190,375
18	24	34	3/687	Gjinovefa Zado	Truall	35.00	8537	298,795
19	11	177	3/645	Dhimitri Zici + bpr	Truall	22.80	8537	194,644
20	17	27	3/576	Marjeta Stralla + bpr	Truall	34.20	8537	291,965
21	17	28	3/577	Marjeta Stralla + bpr	Truall	21.00	8537	179,277
22	18	171	3/590	Vasillaq Orgocka + bpr	Truall	24.00	8537	204,888
23	17	29	3/578	Marjeta Stralla + bpr	Truall	18.00	8537	153,666
24	18	236	3/595	Dylber Kosova	Truall	18.90	8537	161,349
25	18	241	3/598	Kleanthi Papakozma +bpr	Truall	30.24	8537	258,159
26	14	179	3/531	Nikoleta Jani Çupata	Truall	42.40	8537	361,969
27	16	248	2/85	Shemsi Shehu dhe bpr	Truall	1347.00	8537	11,499,339
28	35	182	2/88	Ilia Manol Emanuel + bpr	Truall	879.00	8537	7,504,023
29	16	53	3/564	Dhorothea Stratobërdha + bpr	Truall	60.40	8537	515,635
VLERA TOTALE PËR SHPRONËSIM							30,144,830	